

**UNIVERISTETI I PRISHTINËS HASAN PRISHTINA**



**UDHËZUES PËR APLIKIM ONLINE**

## Përmbajtja

Aplikimi Online.....	4
Shkarkimi i fletë aplikacionit dhe fletëpagesës.....	12
Salla e provimeve.....	13

Figure 1 Lista e Shfletuesve.....	4
Figure 2. Aplikimi Online - Të dhënat Personale.....	4
Figure 3 Të dhënat mbi shkollimin e mesëm .....	5
Figure 4 Vendi i Shkollimit .....	6
Figure 5 Lloji i gjeneratës .....	6
Figure 6 Të dhënat rreth aplikimit .....	7
Figure 7 Fletëparaqitja .....	8
Figure 8 Fletë aplikimi .....	9
Figure 9 Fletëpagesa .....	10
Figure 10 Konfirmimi përmes emailit .....	11
Figure 11 Forma për kërkimin e aplikacionit dhe fletëpagesës .....	12
Figure 12 Informacioni për fletë aplikim dhe fletëpagesë.....	12
Figure 13 Forma për kërkimin e sallës dhe orarin për provimin pranues.....	13
Figure 14 Informatat për sallën, datën dhe orën e provimit pranues .....	13

## Aplikimi Online

Për të aplikuar në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” në ndonjërin nga Programet e studimit në fakultetet e Univeristetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” fillimisht ju duhet të hapni ndonjërin nga shfletuesit (Browseret) e mëposhtëm:



Figure 1 Lista e Shfletuesve

Pastaj shënoni linkun [apliko.uni-pr.edu](http://apliko.uni-pr.edu), me ç ‘rast ju shfaqet forma e mëposhtme për plotësimin e të dhënave personale, të dhënave për shkollim, si dhe të dhënat rreth aplikimit,

Të dhëna personale		
<b>Emri</b> <input type="text"/>	<b>Emri i prindit</b> <input type="text"/>	<b>Mbiemri</b> <input type="text"/>
<b>Numri personal i letërnjoftimit</b> <input type="text"/>	<b>Datëlindja</b> <input type="text"/>	<b>Gjinia</b> <input type="radio"/> Mashkull <input type="radio"/> Femer
<b>Shteti i lindjes</b> <input type="text" value="Zgjedhe"/>	<b>Komuna</b> <input type="text"/>	<b>Vendlindja</b> <input type="text"/>
<b>Kombësia</b> <input type="text" value="Shqiptar"/>	<b>Shteti i vendbanimit</b> <input type="text" value="Zgjedhe"/>	<b>Komuna e vendbanimit</b> <input type="text"/>
<b>Vendbanimi</b> <input type="text"/>	<b>Shtetësia</b> <input type="text" value="Zgjedhe"/>	
<b>Adresa</b> <input type="text"/>	<b>Numri i telefonit</b> <input type="text"/>	<b>Email</b> <input type="text"/>

Figure 2. Aplikimi Online - Të dhënat Personale

Këtu plotësoni këto të dhëna:

**Emri:** Shënoni Emrin

**Emri i Prindit:** Shënoni Emrin e Prindit

**Mbiemri:** Shënoni Mbiemrin

**Numri personal i letërnjoftimit:** Shënoni Numrin personal të letërnjoftimit

**Datëlindja:** Shënoni datën e saktë në formatin *Dita/Muaji/Viti* (Shembull: 26/05/1992), ose zgjidhni nga kalendari datën e lindjes.

**Gjinia:** Përcaktoni *Gjininë*

**Shteti i lindjes:** Zgjidhni nga lista *Shtetin* ku keni lind.

**Komuna:** Nëse keni lindur në Kosovë dhe zgjidhni nga lista Shtetin e lindjes **Kosovë** atëherë te Komuna ju shfaqen të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës, dhe zgjidhni saktësisht Komunën ku keni lind.

Nëse nga lista *Shteti i lindjes* zgjidhni shtet tjetër, atëherë te komuna ju shënoni **Emrin e Komunës** saktësisht ku keni lindur.

**Vendlindja:** Nëse keni lindur në Kosovë dhe zgjidhni nga lista Komunën ku keni lindur, atëherë te *Vendlindja* ju shfaqën të gjithë vendlindjet e mundshme në kuadër të komunës që keni zgjedhur nga lista. Zgjidhni saktësisht vendin e lindjes ku keni lindur.

Nëse nga lista *Shteti i lindjes* zgjidhni shtet tjetër, atëherë te Vendlindja ju shënoni **Emrin e Vendlindjes** saktësisht ku keni lindur.

**Kombësia:** Nëse keni lindur në Kosovë dhe zgjidhni nga lista Shtetin e lindjes Kosovë, atëherë te Kombësia do të ju shfaqen në listë të gjitha Kombësitë që ekzistojnë në Kosovë. Zgjidhni nga lista saktësisht kombësinë tuaj.

**Shteti i Vendbanimit:** Zgjidhni nga lista Shtetin ku banoni.

**Komuna e vendbanimit:** Nëse vendbanimin e përhershëm e keni në **Kosovë** dhe nga lista Shteti i vendbanimit e zgjidhni Kosovë atëherë te Komuna e vendbanimit do të ju shfaqën të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës, dhe zgjidhni saktësisht Komunën ku banoni.

**Vendbanimi:** Nëse keni vendbanim të përhershëm në Kosovë dhe zgjidhni nga lista Komunën ku keni banoni, atëherë te *Vendbanimi* ju shfaqën të gjithë vendbanimet e mundshme në kuadër të komunës që keni zgjedhur nga lista. Zgjidhni saktësisht vendin ku keni banoni.

**Shtetësia:** Zgjidhni nga lista saktësisht *Shtetësinë* tuaj.

**Adresa:** Shënoni saktësisht *Adresën* ku banoni

**Numri i telefonit:** Shënoni saktësisht *numrin e telefonit* tuaj, në formatin +3774 , +386, +355, +381 etj.

**Email:** Shënoni saktësisht *e-mailin* tuaj, e-mail në të cilin pastaj do të vije konfirmimi për aplikim që keni bërë.

Të dhënat mbi shkollimin e mesëm		
Shkolla e mesme <input type="text"/>	Drejtimi në shkollën e mesme <input type="text"/>	Vendi i shkollimit Zgjedhe ▼
Suksesi për vitin e parë (klasa 10) <input type="text" value="0"/>	Suksesi për vitin e dytë (klasa 11) <input type="text" value="0"/>	Suksesi për vitin e tretë (klasa 12) <input type="text" value="0"/>
Suksesi për vitin e katërt (klasa 13) <input type="text" value="0"/>	Lloji i gjeneratës Zgjedhe ▼	

Figure 3 Të dhënat mbi shkollimin e mesëm

Gjatë aplikimit duhet të jepni të dhënat për shkollimin e mesëm

**Shkolla e mesme:** Shënoni *Emrin e shkollës* ku keni kryer shkollën e mesme.

**Drejtimi në shkollën e mesme:** Shënoni *Drejtimin* që keni përfunduar në shkollën e mesme

**Vendi i shkollimit:** Në listë do të shfaqën vendet e shkollimit si më poshtë

**Vendi i shkollimit**

Zgjedhe
Zgjedhe
Kosovë
Jasht Kosove

Figure 4 Vendi i Shkollimit

Nëse shkollimin keni përfunduar në *Kosovë*, atëherë zgjidhni nga lista **Kosovë**, nëse jeni duke aplikuar me kuota të veçanta për *Kandidatët Jo-Kosovarë* sipas konkursit, atëherë zgjidhni nga lista **Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Metvexha**, me ç' rast gjatë shpalljeve të rezultateve do të publikohet listë e veçantë sipas kriterëve që janë të përcaktuara në konkurs.

**Shënim:** Nëse jeni *kandidat Jo-Kosovarë* dhe dëshironi të aplikoni me kuota të barabarta më kandidatët *Kosovarë* atëherë duhet që te vendi i shkollimit të zgjidhni **Kosovë**.

**Suksesi për vitin e parë (klasa 10):** Shënoni suksesin e shkollës së mesme për *klasën e 10* apo *vitin e parë* që keni përfunduar. **Vlera që lejohet të shënohet është nga 2 deri në 5.**

**Suksesi për vitin e dytë (klasa 11):** Shënoni suksesin e shkollës së mesme për *klasën e 11* apo *vitin e dytë* që keni përfunduar. **Vlera që lejohet të shënohet është nga 2 deri në 5.**

**Suksesi për vitin e tretë (klasa 12):** Shënoni suksesin e shkollës së mesme për *klasën e 12* apo *vitin e tretë* që keni përfunduar. **Vlera që lejohet të shënohet është nga 2 deri në 5.**

**Suksesi për vitin e katërt (klasa 13):** Shënoni suksesin e shkollës së mesme për *klasën e 13* apo *vitin e katërt* që keni përfunduar. **Vlera që lejohet të shënohet është nga 0 deri në 5.**

**Lloji i gjeneratës:** Nëse keni zgjedhur që vendin e shkollimit e keni përfunduar në *Kosovë*, atëherë te lloji i gjeneratës në listë shfaqen tri lloje të gjeneratës si në vijim:

**Lloji i gjeneratës**

Gjenerata deri 200 pike
Zgjedhe
Gjenerata deri 200 pike
Gjenerata deri 100 pike
Pa test të matures

Figure 5 Lloji i gjeneratës

- ***Gjenerata deri në 200 pikë***, zgjidhni këtë gjeneratë nëse keni përfunduar në shkollën e mesme me test të maturës në vitin 2014, 2015 apo 2016.
- ***Gjenerata deri në 100 pikë***, zgjidhni këtë gjeneratë nëse keni përfunduar shkollimin e mesëm me test të maturës para vitit 2013.

- **Pa test të maturës**, zgjidhni këtë gjeneratë nëse keni përfunduar shkollimin e mesëm pa test të maturës.

Nëse keni zgjedhur llojin e gjeneratës deri në 200 pikë, atëherë ju shfaqet rubrika *Pikët në Provim të maturës*, ku do të zgjidhni saktësisht sa pikë keni marr në testin e maturës. **Shënim: Në listë keni Maksimumi 200 pikë, dhe minimumi 80 pikë.**

Nëse keni zgjedhur llojin e gjeneratës deri në 100 pikë, atëherë ju shfaqet rubrika *Pikët në Provim të maturës*, ku do të zgjidhni saktësisht sa pikë keni marr në testin e maturës. **Shënim: Në listë keni Maksimumi 100 pikë, dhe minimumi 40 pikë.**

Të dhënat rreth aplikimit

<b>Afati</b> Afati i parë - Bachelor	<b>Fakulteti</b> Fakulteti i Arteve	<b>Departamenti</b> Programi Pikturë
<b>Statusi i studimit</b> I rregullt		

Figure 6 Të dhënat rreth aplikimit

Te të dhënat rreth aplikimit duhet të plotësoni këto të dhëna:

**Afati:** Shfaqet *afati* në të cilin jeni duke aplikuar

**Fakulteti:** Zgjidhni nga lista saktësisht *Fakultetin* në të cilin jeni duke aplikuar

**Departamenti:** Zgjidhni nga lista saktësisht *Departamentin, Drejtimin* apo *Programin e studimit* në të cilin jeni duke aplikuar

**Statusi i studentit:** Zgjidhni nga lista saktësisht *statusin* në të cilin jeni duke aplikuar, ***I rregullt*** apo ***Me korrespondencë***.

Pas plotësimit të komplet të dhenve ju duhet të klikoni në butonin

Apliko

**Nëse nuk i keni plotësuar të dhënat, atëherë do të ju shfaqet mesazhi informues për gabim, varësisht ku nuk i keni dhënë të dhënat.**

Nëse janë plotësuar të gjitha të dhënat siç duhet, atëherë do të shfaqet ky informacion:

# Aplikimi u përfundua me sukses!

Ju duhet të shkarkoni aplikacionin dhe të bëni pagesën.

Pasi të keni realizuar pagesën ju duhet të paraqiteni në fakultetin ku keni aplikuar.

Me rastin e paraqitjes i sjellni këto dokumente:

- Certifikatën e lindjes (origjinal)
- Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal ose të noterizuara)
- Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal ose të noterizuar)
- Kopjen e letërnjoftimit
- Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit
- Fletëparaqitja e plotësuar dhe pagesa prej 2.5 Euro shkarkohet gjatë aplikimit online të cilën duhet ta shkarkoni duke klikuar në butonin e mëposhtëm

Shkarko Aplikacionin dhe pagesën

Aplikim i ri

Figure 7 Fletëparaqitja

Klikoni në [Shkarko Aplikacionin dhe pagesën](#) për të shtypur aplikacionin dhe pagesën për aplikimin që keni bërë.

Forma si do të duket fletëparaqitja dhe fletëpagesa janë si më poshtë:





# UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

## FLETËPARAQITJE

Në bazë të konkursit për pranimin e studentëve të rinj për vitin akademik \_\_\_\_\_ paraqitem për regjistrim në:

Fakulteti					
<b>Fakulteti i Arteve</b>					
Departamenti/Programi					
<b>Dega e Artit Figurativ</b>					
Drejtimi			Statusi		
<b>Programi Dizajn Grafik</b>			<b>I rregullt</b>		
Emri, Emri i prindit dhe Mbiemri			Data, muaji dhe viti i lindjes		
Numri personal			Vendlindja, komuna dhe shteti		
			<b>Topaninë, Kamenicë - Kosovë</b>		
Shtetësia			Përkatësia kombëtare		
<b>Kosovë</b>			<b>Shqiptar</b>		
Tel. mob.			e-mail adresa		
Shkolla mesme - Drejtimi dhe Vendi ku është kryer shkollimi i mesëm					
<b>Shkolla e Mesme Profesionale "Andrea Durrësaku" - Informatikë dhe Matematikë, Kosovë</b>					
Suksesi në shkollën e mesme					
Viti i I-rë/X-të	Viti i II-të/XI-të	Viti i III-të/XII-të	Viti i IV-të/XIII-të	Pikët në provim të maturës*	Suksesi dhe provimi i maturës
5	5	5	0	150	52
Kërkesës i bashkangjisë këto dokumente					
1.	Certifikatën/Ekstraktin e lindjes (Origjinalin)				
2.	Dëftesat e klasës së I, II, III dhe IV, respektivisht X, XI, XII dhe XIII (original ose të noterizuara)				
3.	Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (original ose të noterizuar)				
4.	Kopjen e letërnjoftimit				
5.	Pagesën me shumë prej 2.5 €				
6.	Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit (nostrifikimi)				
Data e aplikimit			Paraqitësi i kërkesës		
<b>04/07/2016</b>			Nënshkrimi _____		
*Pikët në provim të maturës: Gjenerata deri në 200 pikë, pikët pjesëtohen me 4, nëse jeni gjeneratë e re deri 100 pikë në maturë, atëherë pjesëtohen me 2.					

Figure 8 Fletë aplikimi



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"  
UNIVERZITET PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"

Fakulteti i Arteve

FATURË-RAÇUN-INVOICE

598614

Nr. ser · Ser. br · Ser.no

**PARTICIPIMI I STUDENTEVE-PARTICIPACIJA STUDENATA-PARTICIPATION OF STUDENTS**

Emri / Mbiemri  
Ime / Prezime  
Name / Surname

Përshkrimi  
Opis  
Description

Pagesë për afatin pranues.

Shuma  
Iznos  
Amount

€ 2 Euro 50 Ct Data Datum Date 040716

Me fjalë  
Reçima  
In words

Dy Euro Dhe Pesëdhjetë Cent

Llogaria bankare  
Broj žiroraçuna  
Bank account

1000438870000180

Lëshuar nga  
Izdate od  
Issued by

<http://apliko.uni-pr.edu/>

nënshkrimi dhe vula e bankës  
potpis i pecat banke  
bank signature and stamp



Ju duhet të shtypni katër kopje të fletëpagesës dhe të bëni pagesën prej 2.50 euro në postë ose në ndonjërin bankë.

Figure 9 Fletëpagesa

Po ashtu do të pranoni email për aplikimin që keni bërë, nga ku do të keni mundësin e shkarkimit të aplikacionit. Emaili do të ju dërgohet në emailin që keni dhënë gjatë aplikimit.

E nderuar,

Ju njoftojmë se keni aplikuar me sukses në

## Fakulteti i Arteve

### Dega e Artit Figurativ - Programi Dizajn Grafik

Për çdo problem që mund të ju paraqitet gjatë kohës së aplikimit ju mund të lajmëroheni tek shërbimi i studentëve fakultetin ku keni aplikuar.

Për çdo informacion shtesë ju mund të na shkruani në email adresën: [apliko@uni-pr.edu](mailto:apliko@uni-pr.edu)

## Doni të shtypni aplikacionin tuaj përsëri?

Klikoni në linkun në vijim për të shkarkuar aplikacionin përsëri.

[Shkarko aplikacionin](#)


Suksese,


Zyra e Teknologjisë së Informacionit, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".

Figure 10 Konfirmimi përmes emailit

## Shkarkimi i fletë aplikacionit dhe fletëpagesës

Nëse nuk keni shkarkuar aplikacionin, atëherë aplikacionin mund të gjeni në anën e djathtë të faqes,


klikoni në menynë , me ç 'rast ju shfaqet forma në vijim:



The screenshot shows a search form titled "Shtyp Aplikacionin". It contains two input fields: "Afati" (Degree) with a dropdown menu showing "Afati i parë bachelor,," and "Numri personal" (Personal Number) with an empty text box. A blue "Kerko" (Search) button is located to the right of the "Numri personal" field.


Figure 11 Forma për kërkimin e aplikacionit dhe fletëpagesës

Për të kërkuar aplikacionin tuaj dhe fletëpagesën ju duhet të zgjidhni në listë afatin, dhe te Numri personal të shënoni numrin personal të letërnjoftimit, pastaj klikoni në butonin **Kërko**, ku do të shfaqet informata në vijim:



The screenshot shows the results page for the search. It features two buttons: "Shkarko Aplikacionin dhe pagesën" (Download application and payment slip) and "Aplikim i ri" (New application). Below the buttons, there is a message: "Ju duhet të shkarkoni aplikacionin dhe të bëni pagesën." (You need to download the application and make the payment). A section titled "Pasi të keni realizuar pagesën ju duhet të paraqiteni në fakultetin ku keni aplikuar." (After you have completed the payment, you must present yourself at the faculty where you applied.) follows, with a list of required documents: "Me rastin e paraqitjes i sjellni këto dokumente:" (With the submission, bring these documents:). The list includes: "Certifikatën e lindjes (original)", "Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (original ose të noterizuara)", "Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (original ose të noterizuar)", "Kopjen e letërnjoftimit", "Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit", and "Fletëparaqitja e plotësuar dhe pagesa prej 2.5 Euro shkarkohet gjatë aplikimit online të cilën duhet ta shkarkoni duke klikuar në butonin e mëposhtëm".


Figure 12 Informacioni për fletë aplikim dhe fletëpagesë

Për të shtypur fletë aplikacionin dhe fletëpagesën kliko në .

## Salla e provimeve

Për të shikuar në cilën sallë të provimeve, datën dhe orën e saktë ku do të mbani provimin klikoni në

**Salla provimit** e cila gjendet në anën e djathtë të faqes, me ç' rast ju shfaqet forma në vijim:




Kërko sallën e provimit pranues

Afati

Numri personal

Figure 13 Forma për kërkimin e sallës dhe orarin për provimin pranues

Për të gjet saktësisht sallën, datën dhe orën ku do të mbani provimin pranues, duhet të zgjidhni nga lista afatin në të cilin keni aplikuar dhe të shënoni saktësisht numrin personal të letërnjoftimit, me ç' rast do të shfaqën të dhënat si në vijim:



Kërko sallën e provimit pranues

Afati

Numri personal

Provimi pranues mbahet në **Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore**  
salla 113 , me datë 18/07/2016 ne orën 10:30  
Në ditën e provimit duhet të keni me vete letërnjoftimin, dhe konfirmimin për regjistrim të aplikuesit!

Figure 14 Informatat për sallën, datën dhe orën e provimit pranues